



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:201884
Datë: 04.03.2025
Numri i dokumentit: 06937976

AA.nr.968/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit/propozuesit, A.B, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë dhe Organi Shqyrtues i prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimeve, me propozim për vendosjen e masë së sigurisë ndaj vendimeve A.nr.928/2023, të datës 01.09.2023, nr.724/2023, të datës 23.06.2023 dhe konkursit me nr.ref.RN00016792 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;03.03.2025, merr këtë,

A K T V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar propozimi i paditësit-propozuesit A.B, me të cilin ka kërkuar vendosjen e masë së sigurisë kundër vendimit të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.928/2023 të datës 01.09.2023, dhe vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.724/2023 të datës 23.06.2023 dhe konkursit me nr.ref.RN00016792, dhe të pezullohet zbatimi i tyre deri në vendimin përfundimtar të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi i A.B, Komuna e Rahovecit, më datë 24.02.2025, në gjykatën e Apelit ka ushtruar propozim për caktimin e masës së sigurisë, me të cilin ka kërkuar vendosjen e masë së sigurisë kundër vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.928/2023 të datës 01.09.2023 dhe vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.724/223 të datës 23.06.2023 dhe konkursit me nr.ref.RN00016792, dhe të pezullohet zbatimi i tyre deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Ka theksuar se me shpalljen e konkursit për pozitën e propozuesit janë plotësuar të gjitha kushte e parapara me nenin 100 par 1 nëpar 1.1 dhe 1.2 të LKA-së, i cili përcakton se: “1. Masa e sigurisë e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 99 të këtij Ligji, mund të vendoset nëse nga një shqyrtim paraprak, Gjykata, vlerëson se plotësohen këto kushte: 1.1.marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik.” Pra janë plotësuar kushte ligjore që ndaj konkursit me nr.ref.RN00016792 dhe Kod RPC0010331 për pozitën e punës Kryesues i Sekretariatit në OSHP, të vendoset masa e sigurisë dhe për faktin shtese se lejimi i zhvillimit të procedurave të

rekrutimit sipas kësaj shpallje, dhe eventualisht përzgjedhja e kandidatit fitues nga kjo procedure e rekrutimit, padyshim se ke ka prishur edhe gjendjen ekzistuese, e cila gjendje do ta bënte akoma ma te pariparueshëm demin...

Për të vlerësuar propozimin e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, kolegji i apelit iu referua nenit 100 të Ligjit Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative i cili përcakton se “1. Masa e sigurisë e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 99 të këtij Ligji, mund të vendoset nëse nga një shqyrtim paraprak, Gjykata, vlerëson se plotësohen këto kushte: 1.1.marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik.”

Kjo dispozitë në mënyrë qartë përcakton se për caktimin e masë së sigurisë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet e përcaktuara;1.1 marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik.

Duke vlerësuar propozimin e paditësit, gjykata pas shqyrtimit të propozimit, vëren se paditësi përtej përshkrimit të dispozitave relevante ligjore nga nenin 100 të KLA-së, ai është i detyruar duhet të provoj me prova konkrete, argumentet në mbështetje të plotësimin të kriterëve ligjore për caktimin e masës së sigurisë, përkatësisht të provonte me prova se cili është ai dëm që i shkaktohet paditësit, dhe pse ai dëm është i pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës, dhe se marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik, kushte këto ligjore për caktimin e masë së sigurisë, të cilat duhet të provohen nga paditësi. Në këtë drejtim paditësi-propozuesi nuk ka argumentuar me ndonjë provë të besueshme në propozimin e tij se në ketë fazë të procedurës caktimi masës së sigurisë kundër vendimeve të kontestuara-konkursit është e domosdoshme për të shmangur ndonjë dëm të rëndë dhe te pakthyeshëm dhe se caktimi i masës së sigurisë nuk do të cenonte interesin publik.

Kolegji vlerëson se vetëm pretendimi i propozuesit se do ti shkaktohet dëm, e vlerësoi si argument të pamjaftueshëm për caktimin e masë së sigurisë kundër të vendimeve-konkursit të kontestuar, sepse sipas vlerësimit të kolegjit dëmi duhet te jete real, përkatësisht i pakthyeshëm dhe se i njëjti duhet të provohet me prova konkrete.

Prandaj, mbi këto arsye, dhe duke u bazuar në nenin 100 të LKA, lidhur me nenin 296 të LPK-së, kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e refuzuar propozimin e paditësit si të pa bazuar.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.968/2024, datë 03.03.2025

Kryetari i kolegjit
Hajriz Hoti